



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 52.

Prishtinë, më 10.8.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Slavko Simiq, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Fisnik Ismaili, Rustem Berisha dhe Sasha Milosavleviq.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Sanije Berisha- përfaqësuese e OSBE-së, Artan Murati përfaqësues i KDI-së, Zijush Ahmeti -konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz -Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.7.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me amendamentet e Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.7.2016;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 12.07.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Pas diskutimeve në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me amendamentet e Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme.

Veton Berisha, propozoimi i tij ishte që të bëhet nisma për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare. Theksoi se ka pas kontakt me zyrën ligjore të departamentit për mbështetje të komisioneve Parlamentare dhe është informuar se Komisionet kanë kompetenca të bëjnë nismën e ndryshimit të ligjeve.

Për çështjen e ngritur, ai kërkoi të marrë përkrahjen e plotë të Komisionit dhe të fillohet me amendamentimin e Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës. Dha sqarim se qëllimi i

ndryshimit të ligjit është që të inkorporohet dita Nacionale, 24 qershori si festë zyrtare për komunitetin egjiptian, më pas i njëjti do të procedohet për shqyrtim në Komisionin funksional.

Kryesuesja, fillimisht kërkoi që propozimi për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës të dorëzohet në formë të shkruar, më pas komisioni do të merr qëndrim për procedimin e ligjit në fazën e mëtejme.

Qerim Bajrami, në fjalën e tij tha se me rastin e vizitës së komisionit në Republikën e Kroacisë, janë marrë përvoja të mira lidhur me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëmarrja e tyre në Institucionet publike .

Sa i përket promovimit të komuniteteve, ai propozoi që të inicohet shypja e revistave në gjuhën e komuniteteve joshumicë. Lidhur me këtë çështje kërkoi të marrë përkrahjen e plotë të komisionit dhe t'iu drejtohem i Drejtorisë për Çështje të drejtave të komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, që mediat e shtypura të publikohen në gjuhën e komuniteteve joshumicë, Gjithashtu, kjo zyre të parashehë ndarje të veçantë buxhet për publikimin e 12 revistave, në vit.

Kryesuesja, konstatoi se anëtarët e Komisionit pajtohen në formë unanime që temat e lartë ngritura të shtjellohen si pika të veçanta të rendit të ditës, në fillim të muajit shtator.

Danush Ademi, propozimi i tij ishte që në emër të komisionit të kërkohet nga MASHT-i sa janë të aplikueshme masat afirmative për vendet e rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë. Të dërgojnë listën e regjistrimit të kandidatëve për afatin e parë 2016, me mundësi të plotësohen vendet e lira me kandidatë të komuniteteve joshumicë. Paraprakisht të dërgojnë dokumentin për aplikim të kandidatëve, në afatin dytë akademik 2016-2017.

Qerim Bajrami, ishte i të njëjtit mendim që të kërkohet lista e regjistrimit të kandidatëve të pranuar në afatin e parë, ku do të reishikohet mundësia të plotësohen vendet e lira me kandidatë të komuniteteve tjera joshumicë, në afatin e dytë.

Në bazë të diskutimeve, anëtarët e Komisionit u pajtuan në formë unanime, dhe nxorën këtë:

Përfundim

Obligohet administrata për mbështetje të komisionit, ti drejtohet me shkrim MASHT-it, me qëllim të marrjes së informatave lidhur me implementimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2016 për aplikimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë. Të kërkohet lista e regjistrimit të kandidatëve në afat të parë dhe planin e Komisionit Shtetëror për regjistrimin e kandidatëve në afatin e dytë akademik 2016-2017.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković